

Kërkesë për shqyrtimin e kushtetueshmërisë

së

Vendimit Nr.64-04 të Agjencisë së Regjistrimit Civil, Ministria e Punëve të Brendshme

Në bazë të nenit 113, paragrafi 7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës

në

Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

PËRMBAJTJA

I. PALA QË PARASHTRON KËRKESË 1

II. PËRSHKRIMI I PËRMBLEDHUR I FAKTEVE 1

III. ARSYETIMI I KËRKESËS DHE SHKELJET E PRETENDUARA TË KUSHTETUTËS 4

IV. SHTERIMI I MJETEVE JURIDIKE 16

V. DOKUMENTACIONI DHE INFORMATAT PËRCJELLËSE 26

VI. PASQYRA E ZGJIDHJES SË KËRKUAR 27

I. PALA QË PARASHTRON KËRKESË

Blerta Morina, i lindur më [REDAKTUAR] (në vazhdim “Parashtruesi”), përfaqësuar nga Avokatja Rina Kika me seli në Rr. Edith Durham B1 H.1 Nr.11 në Prishtinë, sipas autorizimit të bashkëngjitur.

II. PËRSHKRIMI I PËRMBLEDHUR I FAKTEVE

1. Parashtruesi i Kërkesës është shtetas i Republikës së Kosovës i lindur më 1 mars 1990 në Gjakovë.¹ Që nga fëmijëria ai ka pasur tendencë të vishet si mashkull dhe të identifikohet me gjininë mashkullore, e jo gjininë femërore të përcaktuar në lindje. Si i rritur, Parashtruesi jeton dhe paraqitet si burrë në të gjitha sferat e jetës: në punë, në qytet, gjatë kohës që e kalon me familjen, në shtëpi, gjatë kohës që e kalon me miqtë dhe në të gjitha situatat e rrethanat tjera të jetës së përditshme.

2. Sidoqoftë, emri dhe gjinia e shënuar në dokumentet e tij të identifikimit nuk përkon me emrin me të cilin ai prezantohet dhe me gjininë me të cilën ai identifikohet. Kjo e detyron atë që të kalojë nëpër përvoja të vështira e edhe diskriminuese në jetën e tij të përditshme. Përcaktimi i shënuesit të gjinisë femërore e jo mashkullore, dhe njëherësh emri “**Blerta**”, e jo “**Bler**” në

¹Përgjatë kësaj kërkesë, Parashtruesit të kërkesës do t'i referohemi në gjininë mashkullore nga se kjo është gjinia me të cilën ai identifikohet.

dokumentet e identifikimit paraqesin pengesa të cilat nuk ia lejojnë atij gëzimin e të drejtës në jetë private dhe e venosin në situata që e çenojnë dinjitetin e tij njerëzor. Pengesat në fjalë janë të ndryshme dhe paraqiten në raport me institucionet shtetërore, bankat dhe në të gjitha situata tjera çdo herë që i kërkohet paraqitja e dokumentit të identifikimit. Kjo pasi që në dokumente figuron shënuesi i gjinisë dhe emri femëror, ndërsa Parashtruesi jeton dhe paraqitet si burrë. Përvojë e shpeshtë për Parashtruesin është që gjatë kalimit të pikave kufitare kur i kërkohet të paraqesë dokumentet e identifikimit të kontrollohet gjatë e në detaj dhe të merret në pyetje nga policët kufitarë në lidhje me mospërputhjen e dukjes së tij me gjininë e përcaktuar në dokumentet e tij të identifikimit. Kjo e bën kalimin e pikave kufitare çdo herë një përvojë traumatike për Parashtruesin. Tutje, Parashtruesi është drejtor i OJQ CEL, organizatë kjo që ka fushëveprimin në avokim, mbrojtje dhe përmirësim të jetës së komunitetit LGBT në Kosovë. Për shkak të pozitës së Parashtruesit në organizatë, atij i bie shpesh që të marrë pjesë në konferenca dhe puntori jashtë shtetit andaj secilën herë i bie të kalojë përmes pikave të kontrollit kufitar ku i nënshtrohet kontrollave të panevojshme për shkak të mospërputhjes së dukjes dhe sjelljes së tij me gjininë e paraqitur në dokumentet e tij të identifikimit.

3. Për shumë persona transgjitor nuk është e rëndësishme, e për disa tjerë është fizikisht e pamundur, t'i nënshtrohen procesit të tranzicionit fizik, mirëpo Parashtruesi ka vendosur që të kalojë nëpër këtë proces.² Si rrjedhojë e kësaj, Parashtruesi ka kryer vizitën te Psikologu e Psikoterapeuti Mr. Sci Enver S. Çeska në Prishtinë, i cili pas realizimit një numri të testeve psikologjike, e ka dhënë rekomandimin pozitiv për Parashtruesin për fillimin e tranzicionit fizik nga femër në mashkull përmes trajtimit hormonal.

Prova Nr. 1: Rekomandimi i Psikologut dhe
Psikoterapeut Mr.Sci.Enver S. Çeska, i datës 27

dhjetor 2017. Numri i licencës: KO 03713-70.

4. Në janar 2018, me rekomandimin pozitiv të Psikologut, Parashtruesi ka kryer vizitën mjekësore në Spitalin Klinik Acibadem Sistina në Shkup, Maqedoni dhe ka filluar trajtimin hormonal për tranzicionin fizik nga femër në mashkull.

²"Tranzicioni: Periudha kohore në të cilën individët e ndryshojnë rolin gjinor të ndërlidhur me seksin e përcaktuar në lindje në një rol gjinor tjetër. Për shumë njerëz, kjo përfshinë të mësuarit se si të jetohej në mënyrë sociale në rolin "tjetër" gjinor; për të tjerët ky proces nënkupton gjetjen e rolit dhe shprehjes gjinore me të cilën ndihen më rehat. Tranzicioni mund të përfshijë apo mund edhe të mos përfshijë feminizimin apo maskulinizimin e trupit përmes hormoneve apo procedurave tjera mjekësore. Natyra dhe kohëzgjatja e tranzicionit dallon dhe është e individualizuar", përkthim jozyrtar i definicionit nga *World Professional Association for Transgender Health*, publikimi: "Standards of Care for the Health of Transsexual, Transgender, and Gender Nonconforming People".

Definicioni origjinal: "Transition: Period of time when individuals change from the gender role associated with their sex assigned at birth to a different gender role. For many people, this involves learning how to live socially in "the other" gender role; for others this means finding a gender role and expression that is most comfortable for them. Transition may or may not include feminization or masculinization of the body through hormones or other medical procedures. The nature and duration of transition is variable and individualized."

Prova Nr.2: Raporti Mjekesor, Prof. Dr. Çedomir
Dimitrovski, Spitali Klinik Acibadem Sistina i datës 06

qershor 2018.

5. Rrjedhimisht, pengesat në jetën e përditshme të Parashtruesit si pasojë e mospërputhjes së të dhënave në dokumentet e identifikimit me paraqitjen e Parashtruesit janë bërë gjithnjë e më të shpeshta. Kjo pasi që ndryshimet fizike vazhdojnë të zmadhohen duke krijuar kështu një mospërputhshmëri të madhe ndërmjet pamjes së Parashtruesit dhe të dhënave personale në dokumentet e identifikimit. Si pasojë, emri dhe shënuesi i gjinisë në dokumentet e identifikimit e pengojnë integrimin e plotë të Parashtruesit në shoqëri dhe e vendosin atë në situata të përditshme që çenojnë dinjitetin e tij njerëzor dhe jetën e tij private.

7. Për shkak të arsyeve të lartëcekura, më datë **4 prill 2018**, Parashtruesi ka paraqitur Kërkesën për Ndërrimin e Emrit dhe të Shënuesit të Gjinisë në Regjistrin e Gjendjes Civile pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Komunën e Gjakovës dhe ka kërkuar që t'i ndërrohet emri nga **“Blerta”** në **“Blert”** dhe shënuesi i gjinisë nga **“F”** në **“M”** në Regjistrin e Gjendjes Civile dhe në të gjitha dokumentet e identifikimit, në mënyrë që emri dhe shënuesi i gjinisë të jenë në harmoni me identitetin e tij gjinor.

Prova Nr.3: Kërkesa për ndërrimin e emrit dhe të
shënuesit të gjinisë në Regjistrin e Gjendjes Civile

drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile, 4 prill 2018.

8. Më **13 prill 2018**, Parashtruesi njoftoi Institucionin e Avokatit të Popullit në lidhje me paraqitjen e kërkesës duke pasur parasyshtë rolin e këtij institucioni në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Më datë 16 prill 2018, Institucioni i Avokatit të Popullit e njoftoi Parashtruesin për pranueshmërinë e ankesës së evidentuar me **Ankesa nr.252/2018**.

9. Më **15 maj 2018** Parashtruesi ka pranuar Vendimin Nr.02-201-02-8319 nga Komisioni i Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë, të datës 26 prill 2018, me të cilin e ka refuzuar kërkesën e Parashtruesit si të pabazuar.

Prova Nr.4: Vendimi Nr.02-201-02-8319 i Zyrës së
Gjendjes Civile në Gjakovë i datës 26 prill 2018

10. Më **29 maj 2018** është ushtruar ankesë ndaj Vendimit refuzues të Komisionit të Zyrës së Gjendjes Civile dhe është kërkuar anulimi i tij nga Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave kundër Vendimeve të Zyrave të Gjendjes Civile që funksionon në kuadër të Agjencisë për Regjistrimin Civil (**“ARC”**) për shkak se Vendimi është i paligjshëm dhe diskriminues.

Prova Nr.5: Ankesa ndaj Vendimit të Zyrës së
Gjendjes Civile në Gjakovë, e datës 29 maj 2018

11. Më **25 qershor 2018**, Parashtruesi ka pranuar Vendimit Nr.64-04 e ARC i cili hedhë poshtë si të pabazuar ankesën e Parashtruesit dhe e vërteton Vendimin e Zyrës së Gjendjes Civile me të cilin është hedhur poshtë si e pabazuar Kërkesa e Parashtruesit për ndërrimin e emrit dhe të shënuesit të gjinisë në dokumentet e identifikimit.

Prova Nr. 6: Vendimi Nr.64-04 i datës 13 qershor 2018, Agjencia e Regjistrimit Civil, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave kundër Vendimeve të Zyrave

të Gjendjes Civile, i pranuar më datë 26 qershor 2018

12. Më **24 korrik 2018**, Parashtruesi ka ushtruar Padi për Konfliktin Administrativ brenda afatit ligjor, ndaj Vendimit Nr.64/04 të Agjencisë për Regjistrimin Civil dhe ka kërkuar anulimin e tij nga Gjykata Themelore – Departamenti për Çështje Administrative.

Prova Nr.7: Padi për konfliktin Administrativ kundër Vendimit Nr.64-04 të Agjencisë për Regjistrimin Civil,

dorëzuar më 24 korrik 2018

III. ARSYETIMI I KËRKESËS DHE SHKELJET E PRETENDUARA TË KUSHTETUTËS

1. Me anë të kësaj kërkesë Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese që ta lirojë nga detyrimi i shterjes së të gjitha mjeteve juridike për shkak se procedura sipas padisë për konfliktin administrativ paraqet mjet të papërshtatshëm dhe joefektiv juridik siç spjegohet në pjesën IV të kësaj Kërkesë dhe njëherësh kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të shqyrtojë kushtetutshmërinë e Vendimit Nr.64/04, të nxjerrë nga Agjencia e Regjistrimit Civil (“**ARC**”), të pranuar nga Parashtruesi më datë 26 qershor 2018, me të cilin është vendosur që të refuzohet si e pabazuar ankesa e Parashtruesit ndaj Vendimit Nr.02-201-02-8319 të Zyrës për Gjendjen Civile në Gjakovë, dhe është refuzuar Kërkesa e Parashtruesit për ndërrimin e emrit nga “**Blerta**” në “**Blert**” dhe ndërrimit të shënuesit të gjinisë nga “**F**” në “**M**” në regjistrin e qëndor civil.

2. ARC me nxjerrjen e Vendimit refuzues, ka bërë shkelje të të drejtave dhe lirive të Parashtruesit, përkatësisht, nenit 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës që garanton mbrojtjen e të drejtës së privatësisë bashkë me nenin 8 të KEDNJ që mbron respektimin e të drejtës në jetë private dhe jetë familjare, nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës që garanton pacenueshmërinë e dinjitetit të njeriut, nenin 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës që garanton barazinë dhe mosdiskriminimin para ligjit.

3. Për t’i evidentuar shkeljet gjatë shqyrtimit të kërkesës së Parashtruesit në vazhdim do të trajtohet kronologjikisht rrjedha e procedurës nga paraqitja e kërkesës për ndërrimin e emrit dhe të shënuesit të gjinisë, nxjerrja e vendimit të parë refuzues nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë dhe nxjerrja e vendimit të dytë refuzues nga ARC dhe aspektet që i bëjnë këto dy vendime të kundërligjshme.

Kërkesa e Parashtruesit dhe Vendimet

4. Kërkesa e Parashtruesit me të cilën ka kërkuar që t’i ndërrohet emri dhe shënuesi i gjinisë është bazuar në Ligjin Nr. 02/L-118 për Emrin Personal (“**Ligjin për Emrin Personal**”), Udhëzimin Administrativ Nr.19-2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal (“**Udhëzimi Administrativ për Ndërrimin e Emrit**”), praktikën e Gjykatës

Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“**GJEDNJ**”), Ligjin Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi (“**Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi**”), Ligjin Nr. Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore (“**Ligjin për Barazi Gjinore**”) dhe Kushtetutën e Kosovës. Ndër të tjera kërkesa e parashtruar është mbështetur edhe në nenin 6, paragrafi 1.8 i Udhëzimit Administrativ për Ndërrimin e Emrit, ku parashihet se emri mund të ndërrohet në rastet kur “Emri personal e pengon integrimin e personit në shoqëri”.

5. Më datë 16 maj 2018, Parashtruesi ka pranuar Vendimin e Komisionit të Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë i cili ka marrë vendim si shkallë e parë në procedurë administrative dhe ka vendosur që të refuzojë Kërkesën e Parashtruesit për ndërrim të emrit dhe të shënuesit të gjinisë.

6. Parashtruesi në ankesën ndaj këtij Vendimi të Zyrës së Gjendjes Civile të parashtruar brenda afatit ligjor ka kontestuar ligjshmërinë e Vendimit për shkak se: 1) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj duke u mbështetur mbi një bazë inekzistente ligjore, 2) është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që e rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ për shkak të dështimit të ofrimit të arsytimit dhe adresimit të pretendimeve të Parashtruesit siç kërkohet nga Ligji Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (“**Ligji i Procedurës Administrative**”) dhe 3) për shkak se është nxjerrë në kundërshtim me ligjin material dhe si i tillë në rastin e Parashtruesit është diskriminues.

7. ARC ka refuzuar ankesën e Parashtruesit në procedurë administrative si të pabazuar dhe ka vërtetuar Vendimin e Zyres së Gjendjes Civile në Gjakovë i cili kishte refuzuar kërkesën për ndërrim të emrit dhe të shënuesit të gjinisë në regjistrin qendror civil. Pasi që kërkesa e Parashtruesit përmban në vete dy kërkesa – atë për ndërrimin e emrit dhe tjetrën për ndërrimin e shënuesit të gjinisë - vendimi për refuzimin e tyre do të trajtohet ndaras në vazhdim.

i. Refuzimi i kërkesës për ndërrimin e emrit

8. Në Vendimin refuzues e shkallës së parë për kërkesën e Parashtruesit për ndërrimin e emrit nga „**Bler**ta“ në „**Bler**t“ të nxjerrë nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë theksohet si vijon:

"Shtetasja nuk i plotëson kushtet dhe procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal, Komisioni ka vlerësuar se **arsyeshmëria** e ofruar nga parashtruesja e kërkesës **nuk qëndron dhe nuk e përmbush qëllimin** e nenit 6, paragrafit 1, nënparagrafi 1.8, pasi që emri "Bler

9. Ndërkaq, në Vendimin e shkallës së dytë, pra të nxjerrë nga ARC, në arsyetim thuhet se arsyeja e dhënë për kërkesën e ndërrimit të emrit nuk qëndron sepse Parashtruesi nuk e ka dëshmuar se si emri i deritanishëm, nuk e pengon integrimin e tij në shoqëri. Përkatesisht, në Vendimin e ARC theksohet:

“Komisioni ka shqyrtuar se të gjitha dokumentet dhe shkresat tjera në lëndën e kërkesës së saj dhe konstaton se **arsyeja** që e ka dhënë personi që dëshiron të ndërroj emrin personal për shkak se ky emër personal aktual po e pengon personin

në integrimin e saj në shoqëri **nuk qëndron**, sepse personi nuk ka dhënë asnjë dëshmi, shkresë, shënim tjetër apo fotografi, dokument arkivor që tregon se emri personal Blerta Morina po e pengon personin në integrimin e saj në shoqëri.”

10. Refuzimi i kërkesës nga ARC për ndërrimin e emrit duke u bazuar në mungesën e arsyeshmërisë së kërkesës është i paligjshëm sipas nenit 52, paragrafit 1.1, lexuar së bashku me nenin 4, paragrafi 2 i Ligjit për Procedurën Administrative, sepse është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj duke qenë se e ka refuzuar kërkesën duke u thirrur në një bazë inekzistente ligjore, pra pa pasur autorizim nga një bazë ligjore.

11. Përkatësisht, „mungesa e arsyeshmërisë“ nuk përbën bazë ligjore për refuzimin e kërkesës për ndërrim të emrit. Sipas nenit 4, paragrafi 2 Ligji për Procedurën Administrative përcaktohet si vijon:

"Veprimi Administrativ që cënon apo mund të cënojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj".

12. E drejta për të kërkuar ndërrimin e emrit personal është e drejtë që i takon të gjithë qytetarëve të moshës madhore në Republikën e Kosovës sipas nenit 12 të Ligjit për Emrin Personal, ku përcaktohet:

“Qytetari i moshës madhore mund ta ndërrojë emrin personal në bazë të kërkesës së tij.”

13. Procedura për ndërrimin e emrit i ka kufizimet e veta të cilat janë të parapara në nenin 18 të Ligjit për Emrin Personal ku numërohen pengesat për ndërrimin e emrit personal për qytetarët e moshës madhore në një listë taksative. Asnjëri nga rastet e përmendura nuk e përcakton mungesën e arsyeshmërisë së kërkesës për ndërrimin e emrit si bazë ligjore për refuzimin e kërkesës për ndërrimin e emrit personal. Lista taksative e pengesave në nenin 18 të Ligjit për Emrin Personal numron këto raste:

Neni 18

Pengesat për ndërrimin e emrit personal

"18.1. Qytetarit kundër të cilit zhvillohet procedura për veprë penale për të cilën ndiqet sipas detyrës zyrtare i cili është dënuar për veprë të këtyllë penale, derisa nuk i është ekzekutuar dënimi ose gjithnjë derisa të vazhdojnë pasojat juridike të dënimit, si dhe as personit për të cilin konstatohet se kërkesën e ka paraqitur për t'iu shmangur detyrimeve të përcaktuara me ligj, nuk do t'i lejohet ndërrimi i emrit personal.

18.2. Nëse emri personal i është ndërruar qytetarit, kundër të cilit zhvillohet procedura penale për veprë penale, zyra e gjendjes civile që në afatën prej tre ditësh pas aprovimit të ndërrimit duhet ta njoftojë gjykatën në të cilën zhvillohet procedura penale.

18.3. Zyra e regjistrimit civil mund të kërkojë nga Gjykata dhe Prokuroria verifikimin e vërtetësisë të të dhënave të parashtruara nga aplikuesi lidhur me dokumentet nga neni 17 i këtij ligji.

18.4. Nëse emri personal është ndërruar me kërkesë të palës në procedurë administrative të organit të gjendjes civile, për pesë vitet e ardhshme, palës nuk do t'i lejohet sipas së njëjtës procedurë ndërrimi i serishëm i emrit personal nga organi i gjendjes civile."

14. Pra, bazat e përmendura më sipër janë bazat ligjore mbi të cilat organi përkatës administrativ ka autorizim ligjor dhe mund të nxjerrë vendim refuzues ndaj kërkesës për ndërrim të emrit. Asnjëra nga bazat e mësipërme nuk e përcakton mungesën e arsyeshmërisë së kërkesës si bazë për refuzimin e kërkesës për ndërrim të emrit.

15. Këtu është me rëndësi të theksohet se Ligji për Ndërrimin e Emrit nuk përmbanë asnjë dispozitë që kërkon nga Parashtruesi arsyetimin e kërkesës për ndërrimin e emrit. Më tej, Udhëzimi Administrativ për Ndërrimin e Emrit Personal në nenin 6 i emron arsyet për të cilat shtetasi i Kosovës mund të kërkojë ndërrimin e emrit, mirëpo në asnjë dispozitë nuk përcakton se kërkesa për ndërrimin e emrit mund të refuzohet në rast se arsyeja e dhënë konsiderohet se nuk qëndron apo se është e pamjaftueshme. Përveç formularit, janë një numër dokumentesh që kërkohen për të dëshmuar se personi nuk është nën hetime, se nuk është dënuar për veprë penale, se nuk ka obligime tatimore ndaj shtetit dhe se nuk e ka ndërruar emrin në pesë vitet e fundit. Pra dokumentet që duhet bashkëngjitur në kërkesën për ndërrim të emrit ndërlidhen drejtpërdrejtë me pengesat e listuara në nenin 18 të Ligjit për Ndërrimin e Emrit.

16. Obligimi për deklaram të arsyes për ndërrimin e emrit në bazë të Udhëzimit të lartëcekur, gjatë parashtrimit të kërkesës për ndërrim të emrit është i natyrës deklarative. Kjo kuptohet nga vetë fakti se mjafton që arsyeja të rrumbullaksohet në kërkesë-formularin që dorëzohet për ndërrimin e emrit dhe nuk ka nevojë të paraqitet kërkesë me arsyetim narrativ për personin që kërkon ndërrimin e emrit. Parashtruesi në rastin konkret ka paraqitur kërkesën në formë narrative me vetëdëshirë ku ka shpjeguar se është person transgjinor, dhe bashkë me të e ka dorëzuar edhe formularin e plotësuar të kërkesës së gatshme ku ka shënuar arsyen e paraqitjes së kërkesës për ndërrimin e emrit: "emri e pengon integritimin e personit në shoqëri".

17. Andaj, duke u bazuar në të thënat e mësipërme dhe duke u nisur nga fakti se lista e pengesave për ndërrimin e emrit që përcaktohet në nenin 18 të Ligjit për Ndërrimin e Emrit Personal është listë taksative, organi administrativ nuk mund ta shpikë një bazë të re për refuzimin e kërkesës për ndërrim të emrit sepse autorizimi i tij ligjor është i kufizuar sipas nenit 4, paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Administrative. Ky nen, përcakton se veprimi administrativ që cënon apo mund të cënojë një të drejtë duhet të jetë i autorizuar nga një ligj.

18. Në rastin e Parashtruesit me refuzimin e ndërrimit të emrit të tij nga "**Blerta**" në "**Blert**" kemi të bëjmë me cënimin e të drejtës së tij në privatësi pasi që ARC i ka mohuar të Parashtruesit të drejtën që të njihet me emrin që përkon me identitetin e tij gjinor. E drejta në njohjen e identitetin

gjinor mbrohet brenda të drejtës së privatësisë sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ³, dhe në bazë të nenit 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të KEDNJ. Sipas GJEDNJ koncepti i “të drejtës në jetë private” është term i gjerë dhe nuk mund të kapet në një përkufizim të ngushtë.⁴ Ai e përfshinë integritetin fizik dhe psikik të një personi dhe ndonjëherë mund të përfshijë edhe aspekte të identitetit fizik dhe social individit.⁵ Elemente të tilla si, për shembull identifikimi gjinor, emri, orientimi seksual dhe jeta seksuale hyjnë brenda sferes personale të mbrojtur nga neni 8 KEDNJ.⁶ Për më tepër, GJEDNJ ka theksuar se nocioni i autonomisë personale është princip i rëndësishëm që e përcakton interpretimin e garancave nën nenin 8 KEDNJ dhe që, duke qenë se në vetë esencën e KEDNJ qëndron respekti për dinjitetin dhe lirinë njerëzore, e drejta e personave transgjinor në zhvillim personal, siguri fizike dhe morale është e mbrojtur nga Konventa.⁷

19. Prandaj, Vendimi i ARC me të cilin është refuzuar kërkesa e Parashtruesit për t’ia ndërruar emri ashtu që të jetë në përputhje me identitetin e tij gjinor paraqet shkelje të së drejtës së privatësisë e po ashtu edhe shkelje të së drejtës së pacenueshmërisë së dinjitetit të Parashtruesit që mbrohet me nenin 23 të Kushtetutës së Kosovës.

Vendimi i ARC është diskriminues

20. ARC nuk ka pasur autorizim nga një ligj për ta refuzuar kërkesën për ndërrim të emrit në bazë të “mungesës së arsyeshmërisë së kërkesës”. Përveç kësaj, Vendimi refuzues duhet të anulohet nga Gjykata për shkak se arsyetimi i dhënë për refuzimin e kërkesës është diskriminues. Kjo ngase, ARC konstaton se dhënia e arsyeshmërisë së personi dëshiron ta ndërrojë emrin për shkak të identitetit të tij gjinor, nuk përbën arsye të mjaftueshme për qytetarët e Kosovës që ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre në ndërrimin e emrit. Vendimi refuzues i ARC-së bën dallimin e njëherësh edhe përjashtimin e Parashtruesit në bazë të identitetit të tij gjinor duke cënuar të drejtën e Parashtruesit për tu trajtuar në mënyrë të barabartë dhe për të mos u diskriminuar. Kjo e drejtë është e garantuar me nenin 24 të Kushtetutës së Kosovës, ndërkaq diskriminimi në bazë të identitetit gjinor përcaktohet në nenin 1, paragrafit 1 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Arsyetimi i Vendimit të ARC përputhet plotësisht me definicionin e diskriminimit sipas nenit 3, paragrafi 2 i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, ku theksohet:

“2. Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose cënoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.”

21. Arsyetimi i dhënë nga ARC e përjashton Parashtruesin nga gëzimi i të drejtës së tij në njohjen ligjore të identitetit gjinor duke mos e përfillë identitetin gjinor si kategori të mbrojtur ligjore dhe duke cilësuar se arsyetimi se personi është transgjinor nuk është arsyetim i mjaftueshëm për ta

³Shih praktikën gjyqësore të GEDNJ: B. kundër Francës, nr.13343/87, GJEDNJ, 25 mars 1992; Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.28957/95, GJEDNJ, 11 korrik 2002; A.P., Garçon dhe Nicot kundër Francës, Nr. 79885/12, 52471/13 dhe 52596/13, GJEDNJ, 6 prill 2017.

⁴ Van Kück kundër Gjermanisë, GJEDNJ, Nr.35968/97,12 shtator 2003, paragrafi 69 dhe referencat në të.

⁵ Ibid.

⁶ Ibid.

⁷

Ibid.

gëzuar të drejtën për ta ndërruar emrin. Për më tepër, Vendimi i ARC-së nuk i përgjigjet fare pretendimeve në lidhje me shkeljet e të drejtave fundamentale të Parashtruesit të listuara në ankesën ndaj Vendimit të Zyrës së Gjendjes Civile. E madje nuk i përfillë fare dispozitat e Ligjit për Barazi Gjinore apo Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe nuk i trajton vendimet nga praktika e GJEDNJ të paraqitura nga Parashtruesi si në kërkesën fillestare ashtu edhe në ankesë.

22. Rrjedhimisht, me vërtetimin e Vendimit të Zyres së Gjendjes Civile, ARC i ka mohuar Parashtruesit të drejtën që t'i njihet ligjërisht identiteti i tij gjinor dhe të reflektohet në regjistrin qëndror civil duke e refuzuar kërkesën për heqjen e një shkronje të vetme në emrin e Parashtruesit – pra nga “**Blerta**” në “**Blert**”. Kështu, ARC ka shkelur të drejtën e Parashtruesit në privatësi të garantuar në nenin 36 të Kushtetutës, nenin 8 KEDNJ dhe me praktikën gjyqësore të GJEDNJ, nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës që garanton pacenueshmërinë e dinjitetit të njeriut, nenin 24 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës që garanton barazinë dhe mosdiskriminimin para ligjit. Prandaj, Vendimi refuzues i ARC për ndërrim të emrit është i kundërligjshëm sepse është nxjerrë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet tjera materiale dhe si i tillë Vendimi i ARC është diskriminues dhe si i tillë duhet të anulohet.

Detyrimi për ofrimin e dokumenteve shtesë

23. Në Vendimin e ARC theksohet se Parashtruesi nuk ka dorëzuar dëshmi, fotografi dhe dokumente tjera që do të dëshmonin se emri e pengon integritetin e personit në shoqëri. Detyrimi apo kërkesa kundrejt palës për dorëzimin e dëshmive, shkresave, shënimeve tjera apo fotografive dhe dokumenteve arkivore që e dëshmojnë këtë nuk përmendet as në Ligjin për Ndërrimin e Emrit Personal, as në Udhëzimin Administrativ për Ndërrimin e Emrit Personal dhe as që është kërkuar a përmendur ndonjëherë nga Zyra për Gjendjen Civile në Gjakovë gjatë procesit të paraqitjes së kërkesës, apo nga ARC gjatë procesit të ankimimit të vendimit të Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë.

24. Siç u shtjellua më herët, Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë dhe ARC nuk kanë pasur bazë ligjore për refuzimin e kërkesës për ndërrim të emrit për shkak të mungesës së arsyeshmërisë. Mirëpo, edhe po të qëndronte pretendimi i ARC se kërkesa është dashur të mbështetet me dokumente shtesë që e vërtetojnë arsyeshmërinë e saj, Zyra e Gjendjes Civile dhe ARC kanë pasur obligim që t'i kërkojnë dëshmi shtesë Parashtruesit gjatë paraqitjes së kërkesës, apo gjatë marrjes së vendimit për ankesën e Parashtruesit në mënyrë që ta vërtetojnë drejtë gjendjen faktike.

25. Parimi i informimit dhe ndihmës aktive është një ndër parimet themelore që e rregullon raportin në mes të autoriteteve publike dhe qytetarëve. Përkatësisht, nenit 11 i Ligjit për Procedurën Administrative përcakton:

Neni 11

Parimi i informimit dhe ndihmës aktive

„1. Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që mosdija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike, që ajo ka sipas ligjit. Organi publik, në veçanti, informon palën për të drejtat dhe detyrimet e saj në procedurën administrative, si dhe për pasojat juridike të veprimeve a mosveprimeve të saj gjatë kësaj procedure.

2. Organi publik, gjatë procedurës administrative, ndihmon që palët të mbrojnë dhe realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre juridike, sa më lehtë të jetë e mundur por pa cenuar të drejtat dhe interesat juridik të personave të tjerë.

3. **Organi u siguron personave të interesuar dhe palëve informacion të saktë, të qartë dhe të kuptueshëm rreth:**

3.1. mënyrës si të fillojnë një procedurë të caktuar administrative, brenda fushës përkatëse të kompetencës;

3.2. **kërkesave thelbësore ligjore si dhe procedurave e formaliteteve të parashikuara për nxjerrjen e një akti administrativ apo realizimin e një akti real të kërkuar, përfshirë këtu edhe dokumentet dhe deklaratat që duhen parashtruar;**

3.3. afatit kohor për njoftimin e vendimit përfundimtar, si dhe

3.4. mjeteve juridike në dispozicion të palës dhe mënyrën e ushtrimit të tyre.“

26. Më tutje, sipas nenit 73, paragrafi 4 i Ligjit për Procedurën Administrative parashihet që organi publik duhet të kërkojë plotësimin e kërkesës së palës nëse është e nevojshme, përkatësisht ky nen përcakton:

“Organi publik përpiqet të kuptojë çfarë kërkohet **në kërkesën e parashtruar** dhe nëse është e nevojshme **kontakton kërkuesin për sqarime të metejshme**” apo për plotësimin e saj.”

27. Rrjedhimisht, organi publik ka për detyrë që të marrë iniciativën në raste kur konsideron se informatat shtesë apo dokumentet plotësuese do ta ndihmonin që të kuptojë se çfarë dëshiron që të arrijë pala me kërkesën e parashtruar.

28. Këtu vlen të përmendet se Zyra e Gjendjes Civile, para se të marrë vendim për kërkesat e palëve që kërkojnë ndërrimin e emrit personal merr rekomandim nga ARC për aprovim apo refuzim të kërkesës për ndërrim të emrit. Sipas nenit 8, paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ për Ndërrimin e Emrit, Zyra e Gjendjes Civile vendosë në bazë të Rekomandimit të Komisionit të themeluar nga Ministri për verifikim të kërkesave për ndërrim të emrit. Pra, ARC në momentin kur e ka dhënë rekomandimin negativ për kërkesën e Parashtruesit tek Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë, e ka pasur mundësinë që të shpjegojë qëndrimin e ARC se si mund të dëshmohet ndërrimi i emrit kur ai e pengon integrimin e personit në shoqëri.

29. Në rastin e Parashtruesit, as Zyra e Gjendjes Civile e as ARC nuk e kanë kontaktuar

Parashtruesin dhe nuk kanë kërkuar dëshmi apo dokumente shtesë që do ta mbështesnin kërkesën për ndërrimin e emrit.

30. Më tej, në nenet 131-132 e Ligjit për Procedurën Administrative, parashihet procedura e shqyrtimit të ankesës së palës së pakënaqur nga vendimi i organit kompetent publik dhe përveç tjerash përcaktohet:

Neni 131

Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi kompetent publik

“(…)2. Organi kompetent publik fillimisht do të shqyrtojë nëse ankesa është e pranueshme dhe, vetëm nëse ankesa është e pranueshme, do të shqyrtojë ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e aktit administrativ. Nëse është e nevojshme, organi kompetent publik mund të kryejë shqyrtime (hetime) administrative shtesë. (...)”

Neni 132

Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi epror

“1. Në rastin e paraparë nga paragrafi 5 i nenit 131 të këtij Ligji, organi epror do të shqyrtojë ankesën dhe, nëse është e nevojshme, **do të zhvillojë shqyrtime shtesë, apo do të urdhërojë organin kompetent që të zhvillojë shqyrtime të tilla dhe të njoftojë për to.** Paragrafi 2 dhe 3 i nenit 131 të këtij Ligji zbatohen edhe në këtë rast. (...)”

31. Pra, edhe Zyra e Gjendjes Civile edhe ARC kanë pasur detyrim që të zbatojnë në përpikshmëri procedurën administrative në lidhje me shqyrtimin e kërkesës së Parashtruesit dhe më vonë ankesës së paraqitur ndaj Vendimit të ARC. Rrjedhimisht, këto organe administrative është dashur që Parashtruesit t'i kërkojnë dokumente shtesë dhe të kryejnë hetime shtesë në lidhje me kërkesën dhe ankesën.

32. Rrjedhimisht, Zyra e Gjendjes Civile dhe ARC, së pari nuk kanë pasur autorizim ligjor që të nxjerrin vendim refuzues për kërkesën për ndërrim të emrit për shkak të mungesës së arsyeshmërisë dhe së dyti, edhe po të kishin pasur autorizim ligjor, nuk kanë vepruar konform dispozitave të Ligjit të Procedurës Administrative për vërtetimin e gjendjes faktike. Prandaj Vendimi Nr.64/04 i ARC është nxjerrë në kundërshtim me ligjin material, është diskriminues dhe kundërkushtetues e si i tillë duhet të anulohet nga kjo gjykatë.

ii. Refuzimi i kërkesës për ndërrimin e shënuesit të gjinisë

33. Në Vendimin refuzues të ARC është vlerësuar se kërkesa e Parashtruesit për ndërrimin e shënuesit të gjinisë është e pabazuar sepse nuk ka paraqitur raport mjekësor i cili do të dëshmonte ndërrimin e gjinisë si përbërës i gjendjes civile. Ky Vendim është bazuar në nenin 11 dhe nenin 32 të Ligjit Nr.04/L-003 për Gjendjen Civile („**Ligji për Gjendjen Civile**“).

34. ARC në Vendim ka dhënë arsyetimin si vijon:

„ (...) sipas ligjit nënkuptohet që vërtetimi i gjinisë dhe eventualisht korigjimi i këtij përbërësi të gjendjes civile bëhet vetëm me një raport mjekësor apo vendim mjekësor që sipas Ligjit duhet ta bëjë mjeku, pra paraprakisht personi duhet që **ndryshimet eventuale të përbërësve të gjendjes civile që janë fakte që rrjedhin nga ngjarje natyrore ku përfshihen edhe gjinia e personit si fakt natyror duhet të rregullohen me raport mjekësor** pastaj raporti mjekësor prodhon pasoja juridike në përbërësit e gjinisë civile të një personi si që është e cekur në nenin 32 të Ligjit për Gjendjen Civile.“

35. Pra, sipas ARC, pasi që Parashtruesi nuk ka ofruar raport mjekësor që vërteton ndryshimin e gjinisë si fakt natyre nuk i ka plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 11 dhe nenit 32 të Ligjit për Gjendjen Civile në lidhje me ndërrimin e shënuesit të gjinisë në regjistrin civil qëndror.

36. Neni 11 i Ligjit për Gjendjen Civile parasheh: “Lindja, koha e lindjes, gjinia, amësia dhe vdekja, vërtetohen rregullisht si fakte juridike, nga personat dhe organet të cilëve iu njihet kjo e drejtë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

37. Ndërsa neni 32 i Ligjit për Gjendjen Civile përcakton dokumentet në bazë të lindjes si vijon: “Lindjet si fakt, kohë, vend, gjinia dhe amësia vërtetohen me raport mjekësor ose procesverbal, të

hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm, si dhe përgjegjësi i trenit, kapiteni i anijes ose i aeroplanit në udhëtim, drejtuesi i burgut, organi i rendit publik, apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit, në mungesë të personelit mjekësor.”

38. ARC ka interpretuar procedurën për njohjen ligjore të gjinisë me të cilën identifikohet personi duke u bazuar vetëm në një ligj, e pa i përfillur e konsultuar ligjet tjera e Kushtetutën e Kosovës të cilat përmbajnë përcaktime me rëndësi për rregullimin e kësaj procedure. Rrjedhimisht procedura në fjalë është nxjerrë në kundërshtim me ligjin material dhe Kushtetutën e Kosovës dhe përbën shkelje të lirive dhe të drejtave të njeriut. Pasi që praktika e GEDNJ mbizotëron në interpretimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në legjislacionin kosovar, sipas nenit 53 të Kushtetutës, në vazhdim do të trajtohet vendimi kryesor i GJEDNJ në lidhje me çështjen në shqyrtim e më pas Ligji për Barazi Gjinore.

Praktika e GJEDNJ

39. Kushtëzimi i njohjes ligjore të gjinisë me të cilën personi identifikohet me paraqitjen e raportit mjekësor që vërteton kryerjen e ndryshimin e seksit biologjik (pra ndërhyrjeve kirurgjike dhe/ apo trajtimit hormonal që e shkakton ndryshime të pakthyeshme të sekstit te personi) është trajtuar nga GJEDNJ në vendimin e nxjerrë në vitin 2017 për rastin *A.P. Garçon dhe Nicot kundër Francës*.

40. Sipas GJEDNJ kushtëzimi i njohjes ligjore të gjinisë me ndërhyrje fizike te personat që e kërkojnë këtë të drejtë përcillet me një mundësi të madhe të shkakimit të sterilizimit te personat që e kërkojnë këtë të drejtë, prandaj kushtëzimi i tillë i njohjes ligjore të gjinisë së personit ndërlidhet drejtëpërdrejtë me integritetin fizik të individit.⁸ Në vendimet e mëparshme GJEDNJ ka vendosur se nocioni i autonomisë personale është princip i rëndësishëm gjatë interpretimit të garancave që dalin nga neni 8 i KEDNJ dhe e drejta në identitet gjinor dhe zhvillim personal është aspekt fundamental i të drejtës së privatësisë.⁹

41. Në vendimin për rastin *A.P. Garçon dhe Nicot kundër Francës*, gjykata kishte vërejtur se në Francë, në mënyrë që personi ta fitojë të drejtën që t’i njihet ligjërisht identiteti gjinor, nuk kishte zgjidhje tjetër përpos nënshtrimit të trajtumeve mjekësore, apo ndërhyrjeve kirurgjike të cilat shkaktonin ndryshime të pakthyeshme në dukjen e personit.¹⁰ GJEDNJ konstatoi se kjo praktikë

sipas të gjitha gjasave do të thotë që personi duhet të sterilizohet.¹¹ Mirëpo, jo të gjithë personat

transgjinor dëshirojnë, dhe jo të gjithë munden t’i nënshtrohen trajtimit mjekësor apo ndërhyrjeve kirurgjike që sjellin pasoja të tilla.¹² GJEDNJ ka vendosur se praktika të tilla nuk janë në

⁸A.P., *Garçon dhe Nicot kundër Francës*, Nr. 79885/12, 52471/13 dhe 52596/13, GJEDNJ, 6 prill 2017, paragrafet 120-123.

⁹Van Kück kundër Gjermanisë, GJEDNJ Nr.35968/97,12 shtator 2003, par.69 dhe referencat në të.

¹⁰A.P., *Garçon dhe Nicot kundër Francës*, Nr. 79885/12, 52471/13 dhe 52596/13, GJEDNJ, 6 prill 2017, paragrafi 126.

¹¹Ibid.

¹²Ibid.

përputhshmëri me repektin për lirinë njerëzore dhe dinjitetin që është njëherësh një ndër parimet kryesore të KEDNJ.¹³

42. Rrjedhimisht, me Vendimin e ARC me të cilin është kërkuar raport mjekësor që vërteton ndryshimin e gjinisë, është cënuar dinjiteti i Parashtruesit në bazë të nenit 23 KEDNJ sipas interpretimit të të drejtave dhe lirive të njeriut nga GJEDNJ.

43. Për më tepër, GJEDNJ e ka vlerësuar kushtëzimin e njohjes ligjore të identitetit gjinor edhe brenda të drejtës në pacenueshmërinë e integritetit fizik.¹⁴ Sipas GJEDNJ, në fushën e asistencës mjekësore, imponimi i trajtimit mjekësor ndaj një personi të paafte mendërisht pa pëlqimin e tij ndërhyjnë në të drejtën e tij apo saj në integritet fizik.¹⁵ Trajtimi mjekësor nuk mund të konsiderohet se është dhënë me pëlqim të vërtetë, nëse mos-nënshtrimi ndaj trajtimit mjekësor e pengon personin të gëzojë të drejtën e tij apo saj në identitet gjinor dhe në zhvillim personal i cili është aspekt fundamental i të drejtës për respektimin e jetës private.¹⁶

44. Rrjedhimisht, GJEDNJ ka vlerësuar se kushtëzimi i njohjes së identitetit gjinor të personave transgjinor me ndërhyrje kirurgjike sterilizuese apo trajtim mjekësor, ose ndërhyrje kirurgjike apo trajtim mjekësor që ka mundësi të mëdha të shkaktojë sterilizim, të cilin ata nuk dëshirojnë ta bëjnë, rezulton në kushtëzimin e gëzimit të së drejtës së privatësisë të garantuar me nenin 8 me heqjen dorë nga gëzimi i drejtës së tyre në integritetit fizik që mbrohet edhe nga neni 3 i KEDNJ.¹⁷

45. Prandaj GJEDNJ ka vendosur se refuzimi i kërkesave të parashtruesve për ndryshimin e gjendjes së tyre civile me arsyetimin se ata nuk kanë ofruar prova të pakthyeshme të ndryshimit të dukjes së tyre – pra që iu kanë nënshtruar ndërhyrjeve kirurgjike apo trajtimit mjekësor i cili përmban një mundësi të madhe të sterilizimit – ka për pasojë dështimin e shtetit në përmbushjen e obligimeve pozitive për të siguruar të drejtën në jetë private.¹⁸ Andaj, në lidhje me këtë kushtëzim GJEDNJ ka vendosur se është shkelur e drejta në privatësi e parashtruesve.¹⁹

46. Baza kryesore mbi të cilën është mbështetur Vendimi nga ARC në rastin e Parashtruesit është se Parashtruesi nuk ka ofruar raportin mjekësor i cili i evidenton ndryshimet në gjininë e Parashtruesit. Si i tillë, ky kushtëzim i njohjes ligjore të identitetit gjinor të Parashtruesit është në kundërshtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ e cila është autoriteti kryesor për interpretimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë sipas nenit 53 të Kushtetutës, dhe e shkelë të drejtën e Parashtruesit në jetë private që garantohet me Kushtetutë.

Ligji për Barazi Gjinore

¹³ A.P., Garçon dhe Nicot kundër Francës, Nr. 79885/12, 52471/13 dhe 52596/13, GJEDNJ, 6 prill 2017, paragrafi 128 dhe referencat në të.

¹⁴ A.P., Garçon dhe Nicot kundër Francës, Nr. 79885/12, 52471/13 dhe 52596/13, GJEDNJ, 6 prill 2017, paragrafi 127 dhe referencat në të.

¹⁵ A.P., Garçon dhe Nicot kundër Francës, Nr. 79885/12, 52471/13 dhe 52596/13, GJEDNJ, 6 prill 2017, paragrafi 130 dhe referencat në të.

¹⁶ Ibid.

¹⁷

Ibid, paragrafi 131.

¹⁸

Ibid.

¹⁹

Ibid.

47. Vendimi i ARC me të cilin është refuzuar kërkesa për ndërrimin e shënuesit të gjinisë, përveç që është nxjerrë në kundërshtim me praktikën e GJEDNJ-së, është nxjerrë edhe në kundërshtim me Ligjin për Barazi Gjinore i cili si ligj i veçantë që rregullon çështje që ndërlidhen me gjininë, është dashur të merret parasyshtë nga ARC gjatë marrjes së vendimit.

48. Sipas nenit 3, paragrafi 1.3 të Ligjit për Barazi Gjinore, “gjinia mashkullore” definohet si:

“çdo person që e konsideron veten si të tillë pavarësisht moshës dhe statusit martesor”. Pra në këtë definicion nuk hyn përcaktimi i seksit që personi ka pasur në lindje, por me rëndësi është vetëm përcaktimi subjektiv i gjinisë apo gjinia të cilën personi e konsideron si të veten. Sipas maksimës *lex specialis derogat legi generali*, kur dy ligje përmbajnë dispozita që e rregullojnë çështjen e njëjtë, ligji i veçantë mbizotëron ndaj ligjit të përgjithshëm. Duke qenë se Ligji për Barazi Gjinore është ligj i veçantë (*lex specialis*) që rregullon në mënyrë të veçantë çështje që kanë të bëjnë me gjininë, ky ligj gjithmonë ka përparësi ndaj ligjeve tjera të përgjithshme që trajtojnë çështje që ndërlidhen me gjininë. Në rastin konkret, Ligji për Barazi Gjinore e derogon Ligjin për Gjendjen Civile për shkak se ky i fundit është ligj i përgjithshëm (*lex generali*). Madje Ligji për Barazi Gjinore mbizotëron në interpretimin e çështjes së njohjes së identitetit gjinor edhe sipas maksimës *lex posterior derogat legi priori*, apo ligji i ri mbizotëron ndaj ligjit të vjetër, sepse Ligji për Barazi Gjinore është nxjerrë në vitin 2015, ndërsa Ligji për Gjendjen Civile është nxjerrë në vitin 2011.

49. Në nenin 2, paragrafi 1 të Ligjit për Barazi Gjinore fushëveprimi i këtij ligji përcaktohet si vijon:

“1. Ky ligj vlen për meshkujt, femrat dhe **personat që kanë një karakteristikë të mbrojtur të identitetit gjinor** apo të seksit, **si dhe garanton mundësi dhe trajtim të barabartë, në sferën publike** dhe private të jetës shoqërore, duke përfshirë jetën politike dhe publike, punësimin, arsimin, shëndetësinë, ekonominë, përfitimet shoqërore, sportin, kulturën dhe sferat tjera të përcaktuara me këtë ose ndonjë ligj tjetër.”

50. Identiteti gjinor përcaktohet sipas nenit 3, paragrafi 1.9 të Ligjit për Barazi Gjinore si vijon:

“Identiteti gjinor - kjo karakteristikë e mbrojtur mbulon identitetin që ka të bëjë me gjininë e një personi, dukjen apo karakteristikat tjera që lidhen me gjininë e një personi (**qoftë përmes ndërhyrjes kirurgjike apo jo**) duke mos marrë parasyshtë seksin që personi e ka pasur në lindje.”

51. Pra identiteti gjinor është karakteristikë që gëzon njohje dhe mbrojtje ligjore me apo pa ndërhyrje kirurgjike pa e marrë parasyshtë seksin që personi e ka pasur në lindje. Është e qartë se legjislacioni kosovar ka përbrendësuar konceptin e njohjes së identitetit gjinor të personit edhe pa ndërhyrje kirurgjike, që është njëkohësisht në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ e cila është praktika mbizotëruese për interpretimin e të drejtave të njeriut në Kosovë sipas nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës. Andaj, arsytimi në Vendimin e ARC se Parashtruesi i kërkesës për ndërrim të shënuesit të gjinisë është dashur ta bashkëngjese raportin mjekësor që e vërteton ndryshimin e “gjinisë si fakt natyre” është nxjerrë në kundërshtim me nenin 3, paragrafi 1.9 të Ligjit për Barazi Gjinore dhe në kundërshtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ dhe si i tillë është kundërkushtetues.

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave Civile dhe Politike dhe Deklarata Universale për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut

52. Obligimi për respektimin e të drejtës së privatësisë parashihet edhe te Konventat dhe Instrumentet e tjera për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që përfshihen në nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës. E drejta në privatësi është e mbrojtur edhe nga Deklarata Universale për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave Civile dhe Politike.

53. Forumet kryesore për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në kuadër të Kombeve të Bashkuara, duke u thirrur në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, kanë theksuar se shtetet duhet të parashohin mbrojtje nga dhuna dhe diskriminimi në baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.²⁰ Për më tepër, për të arritur këtë qëllim Këshilli i të Drejtave të Njeriut i Kombeve të Bashkuara për herë të parë ka emëruar një ekspert të pavarur për mbrojtjen nga diskriminimi dhe dhuna e bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor.²¹ Në raportin e tij parë në të cilin ka identifikuar çështjet kryesore që e përcjellin këtë fenomen negativ të shoqërisë, Eksperti i Pavarur ka gjetur se e drejta që identiteti gjinor të njihet në mjetet e identifikimit është thelbësore për këtë komunitet.²² Gjithashtu, mungesa e njohjes ligjore të tyre mundëson një

ambient

të urrejtjes dhe diskriminimit të individëve transgjinor.²³

Kërkesa për kompensimin e dëmit jomaterial

54. Parashtruesi kërkon kompensimin e dëmit jomaterial për shkak të shkeljes së lirive dhe të drejtave të personalitetit, sipas nenit 183, paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (“**LMD**”). Mos-njohja e identitetit gjinor të Parashtruesit me nxjerrjen e vendimit refuzues për ndërrimin e emrit dhe të shënuesit të gjinisë, ka shkaktuar shqetësim dhe vuajtje psikike të Parashtruesi duke e bërë atë të ndihet i përjashtuar dhe i refuzuar nga shoqëria dhe shteti të cilit ai i takon. Më tej, e ka vënë atë në një situatë që e shkelë vazhdimisht të drejtën e tij në privatësi kur i duhet ta tregojë dokumentin e identifikimit.

55. E drejta e kompensimit, Parashtruesit i takon edhe sipas nenit 41 KEDNJ ku përcaktohet kompensimi në rast se gjykata konstaton se ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut. Në shumë raste të shkeljes së të drejtës së privatësisë GJEDNJ ka vendosur që palës i takon e drejta në kompensim të dëmit jo-material. Rast i tillë është rasti *Akvidar dhe të tjerët kundër Turqisë* ku GJEDNJ i dha palëve të drejtën në kompensimin e dëmit jo-material pasi që gjeti se e drejta e tyre në privatësi ishte shkelur nga shteti turk pasi që forcat e sigurisë ia kishin shkatërruar shtëpitë ankuesve.²⁴ Një rast tjetër është rasti *B. kundër Francës* ku GJEDNJ ka vendosur se shteti i Francës ka shkelur të drejtën e privatësisë

²⁰Rezoluta e adaptuar me 30 Qershor 2016 e Këshillit të Drejtave të Njeriut, mund të gjindet në http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/HRC/RES/32/2

²¹Ibid.

²²

Raporti i Ekspertit të Pavarur rreth mbrotjes nga dhuna dhe diskriminimi i bazuar në orientim seksual dhe identitetin gjinor, (A/HRC/35/36 C) Njohja ligjore e identitetit gjinor, paragrafi 57.

²³Ibid.

²⁴

Akvidar dhe të tjerët kundër Turqisë, Nr.21893/93, GJEDNJ, 16 September 1996.

për shkak se nuk ia ka njohur ankueses identitetin e saj gjinor dhe ka urdhëruar që t'i kompensohet shuma prej 100'000 FRF (Franga Franceze).²⁵

56. Në vendimin për rastin *Dolenec kundër Kroacisë* GEDNJ ka ritheksuar se shëndeti mendor është pjesë esenciale e jetës private dhe lidhet me aspektin e integritetit moral të personit.²⁶

Prandaj ruajtja e stabilitetit mendor në këtë kontekst është parakusht i domosdoshëm i respektimit të së drejtës në jetë private.²⁷ Parashtruesi ka përrjetuar dhe vazhdon të përrjetojë shqetësim dhe psiçik për shkak të mosnjohjes së identitetit të tij gjinor nga shteti. Rrjedhimisht, shteti duhet ta kompensojë dëmin jomaterial të shkaktuar për shkak të shkeljes së të drejtës në privatësi dhe të drejtës në jetë të dinjitetshme sipas nenit 13, paragrafi 1 LMD. Parashtruesi kërkon që në emër të dëmit jomaterial t'i kompensohet shuma në lartësi prej **5'000 Euro**.

IV. SHTERIMI I MJETEVE JURIDIKE

57. E drejta e individit që të kërkojë mbrojtje juridike nga Gjykatën Kushtetuese në rast të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tij kushtëzohet nga rregulli i shterjes së mjeteve juridike, megjithatë, Parashtruesit duhet të lirohet nga detyrimi i shterimit të të gjitha mjeteve juridike për shkak të rrethanave të veçanta të rastit të spjeguar më poshtë.

58. Gjykata Kushtetuese ka sqaruar shumëherë në praktikën e saj rëndësinë e detyrimit për të shterur mjetet juridike. Në esencë, ky detyrim përbrendëson parimin e subsidiaritetit, që nënkupton se organet shtetërore dhe gjykatat duhet të kenë fillimisht mundësinë të parandalojnë apo korrigjojnë shkeljet.²⁸ Në të njëjtën kohë, detyrimi për shterjen e mjeteve juridike bazohet në supozimin se juridik i Kosovës siguron mjete efektive për adresimin e shkeljes së të drejtave të parapara në Kushtetutë.²⁹ Mirëpo në rastin konkret, mjetet juridike në dispozicion janë jo-efektive për adresimin e shkeljeve përkatëse.

59. Sipas praktikës së GJEDNJ, mjetet juridike që palët obligohen t'i shterin në lidhje me shkeljet e pretenduara duhet të jenë njëkohësisht **të qasshme** dhe **të mjaftueshme**.³⁰ Ekzistimi i

mjeteve të tilla duhet të jetë mjaftueshëm i sigurtë jo vetëm në teori por edhe në praktikë, përndryshe mjetet juridike do të cilësohen si të papërshtatshme dhe jo-efektive.³¹ Poashtu, sipas

GJEDNJ mund të ekzistojnë rrethana të posaçme të cilat e lirojnë parashtruesin nga detyrimi i shterjes së mjeteve juridike të cilat i ka në dispozicion.³² Këtë interpretim e ka bërë edhe Gjykata

²⁵ *Dolenec kundër Kroacisë*, Nr.13343/87, GJEDNJ, 25 mars 1992, paragrafi 67.

²⁶ *Dolenec kundër Kroacisë*, Nr.25282/06, GJEDNJ 26 nëntor 2009, paragrafi 165 dhe referencat në të.

²⁷ Ibid.

²⁸

Van Oosterwijck kundër Belgjikës, Nr.7654/76, GJEDNJ, 6 nëntor 1980, paragrafi 34 dhe referencat në të; Selmouni kundër Francës, Nr.25803/94, GJEDNJ, 28 korrik 1999, paragrafi 74 dhe referencat në të.

²⁹ Aktvendimi për Papranueshmëri në Rastin Nr.KI47/29, Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., 21 janar 2010, paragrafi 16; Aktvendim për Papranueshmëri në Rastin Nr.KI116/14, Fadil Selmanaj, 19 janar 2015, paragrafi 48.; Selmouni kundër Francës, Nr.25803/94, GJEDNJ, 28 korrik 1999, paragrafi 74.

³⁰

Selmouni kundër Francës, Nr.25803/94, GJEDNJ, 28 korrik 1999, paragrafi 75 dhe referencat në të.

³¹

Selmouni kundër Francës, Nr.25803/94, GJEDNJ, 28 korrik 1999, paragrafi 75 dhe referencat në të.

³²

Van Oosterwijck kundër Belgjikës, Nr.7654/76, GJEDNJ, 6 nëntor 1980, par. 36 dhe referencat në të, Selmouni kundër Francës, Nr.25803/94, GJEDNJ, 28 korrik 1999, paragrafi 75 dhe referencat në të.

Kushtetuese duke cilësuar se parashtruesi i kërkësës në mënyrë që të lirohet nga detyrimi i shterjes së mjeteve juridike të obligueshme duhet të tregojë se:

A. mjeti juridik në të vërtetë është përdorur,

B. mjeti juridik është i papërshtatshëm dhe joefektiv në lidhje e rastin e parashtruesit,

C. ekzistojnë rrethanat e veçanta për shfajsimin e parashtruesit nga kërkesa për të shterur të gjitha mjetet juridike.³³

60. Gjatë trajtimit të detyrimit të palës për shterjen e mjeteve juridike GJEDNJ ka theksuar se zbatimi i rregullës që këtë detyrim duhet ta përfshijë edhe kontekstin.³⁴ Andaj konteksti ligjor dhe politik në rastin e Parashtruesit do të shtjellohet më poshtë në nën-ndarjen “D”.

A. Mjeti juridik në të vërtetë është përdorur

61. Parashtruesi i kërkesës i ka shterur mjetet e rregullta juridike në procedurën administrative duke ushtruar ankesë ndaj Vendimit të Zyrës për Gjendjen Civile në Gjakovë, me të cilin i është refuzuar kërkesa për ndërrimin e emrit dhe të shënuesit të gjinisë në dokumente të identifikimit. Vendimi për ankesën është nxjerrë nga ARC me të cilin është vërtetuar vendimi i shkallës së parë dhe është hedhur poshtë ankesa e Parashtruesit si e pabazuar.

62. Parashtruesi poashtu ka dërguar Padi për Konfliktin Administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative dhe në rast të nxjerrjes së sërishme të vendimit refuzues, do t'i drejtohet Gjykatës së Apelit. Sidoqoftë, Gjykata Kushtetuese duhet ta lirojë Parashtruesin nga detyrimi i shterjes së këtyre mjeteve juridike si e papërshtatshme dhe jo-efektive sepse mjetet në dispozicion ofrojnë siguri vetëm teorike e jo edhe praktike për rastin e Parashtruesit.

B. Mjeti juridik është i papërshtatshëm dhe joefektiv në rastin konkret dhe

C. Rrethanat e veçanta për shfajsimin e parashtruesit nga kërkesa për të shterur të gjitha mjetet juridike

63. E drejta në proces të rregullt dhe pa zvarritje është e garantuar me nenin 6, paragrafi 1 KEDNJ ku përcaktohet se “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe **brenda një afati të arsyeshëm** nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj.”

“Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për **të drejtat dhe obligimet** ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij **brenda një afati të arsyeshëm**, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”

64. GJEDNJ dhe Gjykata Kushtetuese kanë theksuar rëndësinë e ndarjes së drejtësisë pa vonesë dhe ka konfirmuar se vonesa mund ta rrezikojë efikasitetin dhe besueshmërinë e mjetit juridik.³⁵

³³ Aktvendim për Papranueshmëri në Rastin Nr.KI116/14, Fadil Selmanaj, 19 janar 2015, paragrafi 45; Aktvendim për papranueshmëri në Rastin KI145/15, Florent Muçaj, 16 maj 2016, paragrafi 32.

³⁴ Selmouni kundër Francës, Nr.25803/94, GJEDNJ, 28 korrik 1999, paragrafi 77 dhe referencat në të.

65. Sipas Raportit të Përgjithshëm Vjetor 2017 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (“**KGJK**”), në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, janë gjithsej **5,304** lëndë të pazgjidhura.³⁶ Gjatë vitit 2017, janë zgjidhur gjithsej **2,268** lëndë administrative.³⁷ Ndërkaq sipas Raportit të tre mujorit të parë të vitit 2018, është konstatuar se janë gjithsej **5,297** lëndë administrative të pazgjidhura.³⁸ Koha e llogaritur e zgjidhjes së lëndëve administrative në vitin 2017 sipas këtyre të dhënave për një rast llogaritet të jetë përafërsisht **853 ditë** në shkallë të parë.³⁹

66. Në Gjykatën e Apelit, KGJK në vitin 2017 ka konstatuar se janë gjithsej 418 lëndë administrative të pazgjidhura.⁴⁰ Ndëkaq në Raportin e tre mujorit të parë të vitit 2018 ka konstatuar se janë gjithsej **459** lëndë administrative të pazgjidhura.⁴¹ Në vitin 2017, Gjykata e Apelit ka pranuar

890 lëndë administrative, ndërsa i ka zgjedhur **472 lëndë**.⁴² Koha e llogaritur e zgjidhjes së lëndëve administrative sipas këtyre të dhënave për një rast llogaritet të jetë përafërsisht **412 ditë** në shkallë të dytë.

67. Rrjedhimisht, i bie se koha mesatare e llogaritur për zgjidhjen e një lënde administrative që procedohet në Gjykatën Themelore dhe në Gjykatën e Apelit është **3 vite e 4 muaj**.

68. Komisioni Evropian, në Raportin për Kosovën të publikuar në prill 2018 ka vlerësuar se numri i madh i lëndëve administrative të pazgjidhura në Gjykatën Themelore vështirë se do të zvogëlohet në të ardhmen, sidomos duke pasur parasyshë ligjin e ri për kundërvajtje që ka hyrë në fuqi në janar 2017 i cili rrezikon rritjen e numrit të lëndëve të pazgjidhura.⁴³

69. Në anën tjetër ekziston mundësia reale që Gjykata Themelore të mos e vendosë rastin sipas meritave por vetëm ta kthejë në procedurë administrative që e bën kohëzgjatjen e procedurës së paku dy fish më të gjatë. Këtë problem të trajtimit të lëndëve administrative nga Gjyqësori e ka konstatuar edhe Avokati i Popullit në Raportin Ex Officio nr.425/2015 lidhur me mungesën e mjeteve efektive juridike drejtuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë.⁴⁴ Avokati i Popullit ka konstatuar se në kontestet administrative gjykatat

ne asnjërin nga procedurat e përkatëse nuk janë lëshuar në shqyrtimin e meritave të rastit por vetëm i ³⁶H kundër Francës, Nr.10073/82, GJEDNJ, 24 tetor 1989, paragrafi 58 dhe referencat në të; Aktvendim për papranueshmëri në Rastin KI145/15, Florent Muçaj, 16 maj 2016, paragrafi 33.

³⁶ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raporti Statistikor i Gjykatave për Vitin 2017*, 2017, faqe 9.

³⁷ Ibid.

³⁸ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raporti Statustikor i Tremujorit të parë 2018 mbi punën e gjykatave*, 2018, faqe 9.

³⁹ Kjo formulë e llogaritjes së kohës mesatare për zgjidhjen e lëndëve përdoret nga Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian për matjen e efikasitetit të gjykatave. Llogaritja e procedurave tregon kohën e përafërt në ditë që nevojitet për tu zgjidhur një rast nga gjykata. Ky tregues llogaritet duke e përpjestuar numrin e lëndëve të pazgjidhura me numrin e lëndëve të zgjidhura, e në fund duke e shumëzuar me numrin e ditëve të vitit 365. Shih: European Commission, *The 2017 EU Justice Scoreboard*, 2017, faqe 7, https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/justice_scoreboard_2017_en.pdf. Kjo formulë është pranuar edhe nga Qeveria e Kosovës, shih: Qeveria e Kosovës, Ministria e Administratës Publike, *Koncept Dokument për Kontestet Administrative*, prill 2017, faqe 4.

⁴⁰ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raporti Statistikor i Gjykatave për Vitin 2017*, 2017 faqe 7.

⁴¹ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raporti Statustikor i Tremujorit të parë 2018 mbi punën e gjykatave*, 2018, faqe 7.

⁴² Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raporti Statistikor i Gjykatave për Vitin 2017*, 2017 faqe 7.

⁴³ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, 17 prill 2018, faqe 12.

⁴⁴ Institucioni i Avokatit të Popullit, *Raport Ex-Officio nr.425/2015, lidhur me mungesën e mjeteve juridike efektive drejtuar Ministrisë së Punës dhe mirëqenies Sociale dhe Gjykatës Themelore të Prishtinës*, 22 gusht 2016, faqe 13.

kanë konstatuar shkeljet proceduale.⁴⁵ Si pasojë, Avokati i Popullit ka evidentuar se rastet kthehen në rishqyrtim tek organi i cili e ka marrë fillimisht vendimin dhe ai vendosë sërish njëjtë, dhe pala sërish paraqet padi pranë gjykatës.⁴⁶ Ndër të tjera ka konstatuar se ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut nga se paditë e ushtruara nga ankuesit të cilëve për shkak se mjetet juridike në ish-in joefektive dhe nuk siguronin realizimin e të drejtës që u takonte ankuesve.⁴⁷

70. Siç u përmend më sipër, Parashtruesi ka filluar fazën e tranzicionit fizik në janar 2018 dhe për shkak të trajtimit hormonal ai tashmë ka filluar të ketë ndryshime të dallueshme fizike duke i humbur karakteristikat femërore. Pra, deri në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë kanë kaluar gjithsej 7 muaj që nga fillimi i tranzicionit nga ana e Parashtruesit por ndryshimet fizike janë qartë të dallueshme siç dëshmohet nga Raporti Mjeksor në Spitalin Acibadem Sistina i muajit qershor 2018 i bashkëngjitur këtu si Prova Nr.2.

71. Rrjedhimisht, mospërputhja e identitetit gjinor me të cilin Parashtruesi identifikohet po bëhet gjithnjë e më e dallueshme dhe ka për pasojë në shkelje të njëpasnjëshme të së drejtës së tij në privatësi, e cila është e mbrojtur sipas nenit 33 të Kushtetutës së Kosovës, sipas nenit 8 të KEDNJ dhe praktikës së GJEDNJ.

72. Për shkak se në Kosovë mungon përkujdesja shëndetësore dhe shërbimet tjera mjeksore për personat transgjinor ashtu siç edhe është konstatuar nga Raportin “Mbrojtja sociale dhe qasja në kujdesin shëndetësor për personat transgjinorë në Kosovë,”⁴⁸ Parashtruesi trajtimin e tij

hormonal

dhe vizitat mjekësore i kryen në Shkup – Maqedoni, në spitalin Sistina.⁴⁹ Gjatë vitit të parë të tranzicionit i cili ka filluar në janar të këtij viti, Parashtruesit i duhet të bëjë vizita mjeksore çdo katër muaj (Shih Proven Nr. 2). Kjo do të thotë se për secilën vizitë mjekësore, Parashtruesi duhet ta kalojë dy herë pikën kufitare Kosovë-Maqedoni dhe t’i nënshtrohet kontrollit kufitar e të tregojë çdo herë dokumentet e identifikimit të cilat nuk e reflektojnë identitetin gjinor të Parashtruesit dhe nuk përputhen me dukjen e tij dhe ndryshimet fizike që ndodhin si rezultat i tranzicionit fizik.

73. Tutje, Parashtruesi është drejtor i OJQ CEL, organizatë kjo që ka fushëveprimin në avokim, mbrojtje dhe përmirësim të jetës së komunitetit LGBT në Kosovë. Për shkak të pozitës së Parashtruesit në organizatë, atij i bie shpesh që të marrë pjesë në konferenca dhe puntori jashtë shtetit andaj secilën herë i bie të kalojë përmes pikave të kontrollit kufitar ku i nënshtrohet kontrollave tjera të panevojshme për shkak të mospërputhjes së dukjes dhe sjelljes së tij me dokumentet e tij të identifikimit.

74. Rrjedhimisht, pa e paragjykuar vendimin që do ta merrte Gjykata Themelore në Prishtinë apo Gjykata e Apelit, periudha e stërgjatë kohore për shqyrtimin dhe zgjidhjen e një lënde administrative në rastin e Parashtruesit e bën mjetin juridik të papërshtatshëm dhe joefektiv pikërisht për shkak të rrethanave të veçanta të rastit konkret. Prandaj, për Parashtruesin ushtrimi i Padisë për

⁴⁵Ibid.
⁴⁶Ibid.

⁴⁷Ibid.

⁴⁸

CEL & CSGD, Koalicioni i të drejtave të barabarta për të gjithë ERAC, *Mbrojtja sociale dhe qasja në kujdesin shëndetësor për personat transgjinorë në Kosovë*, 2016, faqe 41-44.

⁴⁹Shih faqen zyrtare të Spitalit Acibadem Sistina në Shkup ku përcaktohen shërbimet e përkujdesit mjeksor ndaj personave transgjinor, <https://reconstructivesurgery.acibademsistina.com/>

Konfliktin Administrativ pranë Gjykatës Themelore e mëpas potencialisht pranë Gjykatës së Apelit nuk paraqet mjet juridik efektiv sepse nuk e siguron adresimin e shkeljes së të drejtave të Parashtruesit brenda një kohe të arsyeshme siç garantohet me Kushtetutë dhe me KEDNJ. Poashtu, pritja e gjatë ka për pasojë shkelje të mëdha e të vazhdueshme të së drejtës së privatësisë së Parashtruesit çdo herë që i duhet ta kalojë kufirin e Kosovës.

Arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave

75. Në vendimet paraprake, Gjykata Kushtetuese dhe GJEDNJ kanë theksuar se kohëzgjatja e procedurave në vetvete nuk e bën mjetin efektiv joefektiv dhe se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet sipas rrethanave të rastit, përkatësisht:

- i. ndërlíkueshmëria e rastit,
- ii. sjellja e parashtruesit dhe autoriteteve relevante,
- iii. çfarë ka qenë në shqyrtim për parashtruesin në atë kontest.⁵⁰

i. Ndërlíkueshmëria e rastit

76. GJEDNJ e ka marrë parasyshtë ndërlíkueshmërinë e rastit gjatë vlerësimit se a e kanë përmbushur gjykatat kriterin e **shqyrtimit të rastit brenda një kohe të arsyeshme** që është detyrim pozitiv për shtetet nënshkruese sipas nenit 6 KEDNJ. Në vendimet *Frylender kundër Francës* dhe *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë*, 51 GJEDNJ ka konsideruar se në këto raste nuk ka pasur arsytim që procesi gjyqësor të zvarritet aq shumë pasi që rastet nuk kanë qenë edhe aq të ndërlíkua.⁵²

77. Ndërlíkueshmëria e rastit mund të ndërlídhjet me faktet dhe me ligjin e aplikueshëm.⁵³ Për shembull, në raste kur ka shumë palë apo nëse ka një numër të madh provash që duhen të mbildhen rasti mund të konsiderohet si i ndërlíkuar.⁵⁴ Në rastin e Parashtruesit e kemi vetëm një palë e cila e kërkon të drejtën e vetë për ta ndërruar emrin dhe shënuesin e gjinisë dhe të gjitha provat me rëndësi janë të bashkëngjitura në këtë kërkesë.

78. Sa i përket ndërlíkueshmërisë ligjore të rastit, GJEDNJ ka vlerësuar se në rastet kur ka pak precedente në nivel nacional apo kur ekziston nevoja që të konsultohen organe tjera për interpretimin e ligjit.⁵⁵ Sidoqoftë, GJEDNJ ka vlerësuar se vetëm ndërlíkueshmëria ligjore nuk e arsyeton kohëzgjatjen e stërgjatë të procedurës gjyqësore.⁵⁶ Kërkesa e Parashtruesit për ndërrim të

⁵⁰ *Frylender kundër Francës*, Nr.30979/96, 27 GJEDNJ, qershor 2000, paragrafi 143; *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë*, Nr.35382/97, GJEDNJ, paragrafi 19.

⁵¹ *Frylender kundër Francës*, Nr.30979/96, GJEDNJ, 27 qershor 2000, par.44; *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë*, Nr.35382/97, GJEDNJ, 6 prill 2000, paragrafi 20.

⁵² *Ibid.*

⁵³

⁵⁴ *Katte Klitsche de la Grance kundër Italisë*, paragrafi 55; *Papachelas kundër Greqisë*, paragrafi 39

⁵⁵

⁵⁶ *H kundër Britanisë së Madhe*, Nr.9580/81, GJEDNJ, paragrafi 72; *Humen kundër Polonisë*, Nr.26614/95, GJEDNJ, 15 tetor 1999, paragrafi 63.

⁵⁵ *Satakunnan Makkinapössi oy dhe Satamedia OY kundër Finlandës*, Nr. 931/13 GJEDNJ, 27 qershor 2017, paragrafi 212.

⁵⁶ *Ibid.*

gjinor është kategori e mbrojtur ligjore sipas nenit 1 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 3, par.1.9 të Ligjit për Barazi Gjinore dhe hyn në kuadër të obligimeve pozitive të shtetit për mbrojtjen e të drejtës së privatësisë sipas nenit 36, nenit 22, nenit 53 të Kushtetutës. Praktika gjyqësore e GJEDNJ ka vendosur një mori rastesh të cilat specifikojnë obligimin pozitiv të shtetit për njohjen ligjore të gjinisë me të cilën identifikohet personi dhe ofron një praktikë të gjerë të asaj se çfarë mund të konsiderohet si shkelje e të drejtës së privatësisë në kontekstin e njohjes ligjore të identitetit gjinor e çka jo.⁵⁷ Duke marrë parasyshë faktin se të drejtat dhe liritë e qytetarëve të Kosovës interpretohen në harmoni me vendimet e GJEDNJ, nuk mund të konsiderohet se rasti është i ndërlikuar ligjorisht. Fakti se është rasti i parë i paraqitur nga një person transgjinor që kërkon t'i njihet identiteti i tij gjinor ligjorisht dhe emri i tij të ndërrohet ashtu që të përkojë me identitetin e tij gjinor nuk do të duhej të konsiderohej si karakteristikë që e bën rastin e ndërlikuar. Kjo nga se baza ligjore e interpretimit të obligimeve pozitive të shtetit në rastin konkret është e qartë.

ii. Sjellja e parashtruesit dhe autoriteve relevante

79. Parashtruesi ka ushtruar ankesë dhe padë brenda afatit ligjor dhe nuk ekziston asnjë rrethanë a provë për të konsideruar se sjellja e Parashtruesit ka ndikuar apo se do të ndikonte në zvarritjen e procedurës. Parashtruesi e sheh ndërtrimin e emrit dhe të shënuesit të gjinisë si çështje esenciale për zhvillimin e tij personal dhe shoqëror, andaj është i gatshëm t'i shfrytëzojë të gjitha mjetet juridike deri në njohjen ligjore të identitetit të tij gjinor.

80. Sa i përket sjelljes së autoriteteve relevante në lidhje me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjes në fjalë vijnë në shprehje argumentet e paraqitura më sipër në lidhje me zvarritjen e procedurës së shqyrtimit të lëndëve të konfliktit administrativ nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative. Poashtu vjen në shprehje rreziku që ndodhë në të shumtën e rasteve, ku Gjykata Themelore nuk e vendosë rastin sipas meritave por vendosë t'ia kthejë organeve të administratës për rivendosje, e këto të fundit në të shumtën e rasteve vendosin njësoj si herën e parë. Rrjedhimisht përgjegjësia për zvarritjen e procedurës bie mbi autoritetet përkatëse.

81. Prandaj gjatë trajtimit të pranueshmërisë së kërkesës duke pasur parasyshë në njërën anë, zvarritjen e procedurave gjyqësore, numrin e madh të lëndëve të pazgjidhura në konteste administrative, mundësinë e kthimit të lëndës nga gjykata sërish në procedurë administrative dhe nxjerrjen e vendimit të njëjtë nga ARC, dhe në anën tjetër duhet pasur parasyshë gatishmërinë e Parashtruesit të kërkesës për t'i shfrytëzuar të gjitha mjetet për të arritur deri te njohja ligjore e identitetit të tij ligjor.

iii. Çështja në shqyrtim për parashtruesin

82. Siç u përmend edhe më sipër, Parashtruesi është duke iu nënshtruar procesit të tranzicionit fizik dhe ndryshimet fizike po bëhen gjithnjë e më të dukshme. Pasi që për vizitat mjekësore si dhe për udhëtimet jashtë vendit Parashtruesit do t'i duhet të dalë nga Kosova dhe të kalojë përmes

⁵⁷ B. kundër Francës, nr.13343/87, GJEDNJ, 25 mars 1992; Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.28957/95, GJEDNJ, 11 korrik 2002; A.P., Garçon dhe Nicot kundër Francës, Nr. 79885/12, 52471/13 dhe 52596/13, GJEDNJ, 6 prill 2017.

kontrollit kufitar, çështja e ndërrimit të emrit dhe të shënuesit të gjinisë është esenciale për Parashtruesin. Mos-trajtimi i lëndës së Parashtruesit në kohë të arsyeshme do të shkaktonte shkelje të të drejtave të tij, pasi që do të vazhdonte gjendja e mos-përputhjes së emrit dhe gjinisë me të cilin Parashtruesi identifikohet dhe paraqitet, me emrin dhe shënuesin e gjinisë që figuron në dokumentet e tij të identifikimit ndërsa Gjykata nuk do të arrijë ta shqyrtojë lëndën e tij brenda kohës së arsyeshme.

83. GJEDNJ e ka vlerësuar në një numër rastesh kriterin e “çështjes në shqyrtim për parashtruesin” si rrethanë e veçantë për vlerësimin e shkeljes të së drejtës në gjykim brenda një kohe të arsyeshme të garantuar me nenin 6 KEDNJ. Në mes tjerash, këtë kriter në lidhje me lëndët që kanë të bëjnë me gjendjen civile GJEDNJ e ka trajtuar në rastet: *Bock kundër Gjermanisë*, *Laino kundër Italisë* dhe *Mikulic kundër Kroacisë*.⁵⁸ Gjykata ka vlerësuar se në raste që kanë të bëjnë me

gjendjen

civile të parashtruesve, kërkohet një kujdes i veçantë për shqyrtimin tyre brenda një kohe të arsyeshme.⁵⁹ Në të tri rastet e mësipërme, GJEDNJ ka gjetur shkelje të së drejtës në gjykim

brenda

një kohe të arsyeshme sipas nenit 6, paragrafit 1 të KEDNJ.⁶⁰

84. Në rastin *Mikulic kundër Kroacisë*, Parashtruesja kishte paraqitur padi për vërtetimin e atësisë para gjykatës në Zagreb ndërsa procedura kishte zgjatur 4 vite në shkallë të parë dhe 4 muaj në shkallë të dytë.⁶¹ GJEDNJ ka vlerësuar se zvarritja e procedurave nga gjykata kroate ka shkaktuar

që

parashtruesja të mbetet e pasigurtë në lidhje me identitetin e saj personal për një kohë të stërgjate.⁶²

Rasti i Parashtruesit ka të bëjë me emrin dhe shënuesin e gjinisë në dokumente të identifikimit të dyja këto janë përbërës të gjendjes civile të Parashtruesit sipas nenit 9, paragrafi 1 i Ligjit për Gjendjen Civile. Prandaj lënda e Parashtruesit duhet të trajtohet me kujdes të veçantë për shqyrtimin e tij brenda një kohe të arsyeshme. Mirëpo, Gjykata Themelore në Prishtinë nuk mund ta trajtojë lëndën brenda një kohe të arsyeshme për shkak të numrit të madh të lëndëve të pazgjidhura prandaj padia për konfliktin administrativ paraqet mjet të papërshtatshëm dhe jo-efektiv juridik për Parashtruesin.

Përfundim

85. Parashtruesi duhet të lirohet nga detyrimi i shterjes së të gjitha mjeteve juridike për shkak se rrethanat e rastit të tij e bëjnë pritjen e procedimit të padisë nga Gjykata Themelore mjet jo-efektiv dhe të papërshtatshëm. Çështja e parë që e pamundëson adresimin e shkeljeve të të drejtave të Parashtruesit nga Gjykata Themelore është fakti se Gjykata Themelore nuk do të arrijë ta shqyrtojë për një kohë të gjatë lëndën e Parashtruesit për shkak të numrit të madh të lëndëve të pazgjidhura me të cilat ballafaqohet. Çështja e dytë është se Parashtruesi ka filluar tranzicionin fizik dhe mospërputhja në mes të dokumenteve të identifikimit dhe dukjes po bëhet gjithnjë e më e madhe.

⁵⁸ *Bock kundër Gjermanisë*, Nr.11118/84, GJEDNJ, 21 shkurt 2018, paragrafi 49; *Laino kundër Italisë*, GJEDNJ, 18 shkurt 1999, paragrafi 18; *Mikulic kundër Kroacisë*, GJEDNJ, 7 shkurt 2002, paragrafi 44.

⁵⁹ *Ibid.*
⁶⁰ *Bock kundër Gjermanisë*, Nr.11118/84, GJEDNJ, 21 shkurt 2018, paragrafi 49; *Laino kundër Italisë*, GJEDNJ, 18 shkurt 1999, paragrafi 22; *Mikulic kundër Kroacisë*, GJEDNJ, 7 shkurt 2002, paragrafi 46.

⁶¹ *Mikulic kundër Kroacisë*, GJEDNJ, 7 shkurt 2002, paragrafi 8 dhe 45.

⁶²

Ibid., paragrafi 66.

kalojë pikën kufitare duke e bërë kështu t'i nënshtrohet shkeljeve të vazhdueshme të së drejtës në privatësi.

86. Sa i përket arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave mund të përfundohet se rasti i Parashtruesit nuk është i ndërlidhur me ndërlidhim të tepërt që do ta arsyetonte kohëzgjatjen e tepërt në procedimin e rastit. Zvarritja e procedurave në departamentin administrativ është pothuajse gjithmonë për shkak të vetë gjykatës dhe sistemit gjyqësor e jo për shkak të sjelljes së palëve në procedurë. Andaj edhe në rastin e Parashtruesit zvarritja e procedurës do të vie si pasojë e sistemit gjyqësor dhe jo për shkak të sjelljes së Parashtruesit. Ky i fundit ka dëshmuar se është i gatshëm t'i ndjekë të gjitha mjetet ligjore dhe deri tani i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet që i ka pasur në dispozicion për ta realizuar të drejtën e vet. Në fund, çështja që është në shqyrtim për Parashtruesin, për shkak se ka të bëjë me gjendjen civile të Parashtruesit dikton që duhet të trajtohet me përkujdesje të veçantë dhe të mos ketë zvarritje sipas GJEDNJ.

87. Për shkak të këtyre arsyeve, Parashtruesi duhet të lirohet nga obligimi i shterjes së mjeteve juridike në procedurë gjyqësore pasi që në rastin e tij, ato janë të papërshtatshme dhe jo-efektive.

D. Konteksti ligjor dhe politik në lidhje me rastin e Parashtruesit

88. GJEDNJ ka theksuar se zbatimi i rregullës që përcakton detyrimin për shterjen e mjeteve juridike duhet ta përfshijë edhe kontekstin.⁶³ Sipas GJEDNJ rregulli i shterjes së mjeteve juridike

duhet të zbatohet me një nivel të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepruar.⁶⁴ Detyrimi i shterjes së

mjeteve juridike nuk është absolut dhe nuk mund të zbatohet automatikisht, për këtë arsye gjatë vlerësimit të detyrimit për shterje, gjykata ka përcaktuar se është esenciale të shqyrtohen rrethanat e veçanta dhe individuale të rastit përkatës.⁶⁵ Kjo, sipas gjykatës do të thotë që nuk duhet të merren

parasyshë vetëm mjetet formale të sistemit ligjor por edhe konteksti i përgjithshëm ligjor dhe politik i shtetit si dhe rrethanat personale të parashtruesit.⁶⁶

89. Në kontekstin e përgjithshëm politik e ligjor, në rastin konkret duhet pasur parasyshë faktin se komuniteti transgjinnor është kategori tejet e margjinalizuar dhe e paragjykuar në shoqërinë Kosovare. Ky është fakt notor, ndërsa është konfirmuar edhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit në Amicus Curie dërguar Gjykatës Themelore në Prishtinë në lidhje me gjendjen e homofobisë dhe transfobisë në Kosovë si dhe në Raportin Vjetor për vitin 2017.⁶⁷

90. Për trajtimin e kontekstit politik të komunitetit transgjinnor në Kosovë është e rëndësishme të përmenden dy ngjarjet më të rëndësishme në historinë e komunitetit LGBTI në Kosovë: sulmi ndaj Kosovo 2.0 në vitin 2012 dhe organizimi i Paradës së Krenarisë në vitin 2017.

⁶³ Selmouni kundër Francës, Nr.25803/94, GJEDNJ, 28 korrik 1999, paragrafi 77 dhe referencat në të.

⁶⁴

Ibid.

⁶⁵

Selmouni kundër Francës, Nr.25803/94, GJEDNJ, 28 korrik 1999, paragrafi 77.

⁶⁶

Selmouni kundër Francës, Nr.25803/94, GJEDNJ, 28 korrik 1999, paragrafi 77, Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë, GJEDNJ, paragrafi 69.

⁶⁷ Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, *Mendim Juridik i Avokatit të Popullit në Cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) për Gjykatën Themelore në Prishtinë në lidhje me gjendjen e homofobisë dhe transfobisë*, nr.689/2017, 2 maj 2017, faqe 6.

91. Më 14 dhjetor 2012 u ndërpre dhunshëm organizimi i ngjarjes së lansimit të edicionit të gazetës Kosovo 2.0 që e trajtonte temën e seksit, seksualitetit dhe çështjet e komunitetit LGBTI.⁶⁸ Kjo ngjarje shpërfaqti homofobinë dhe transfobinë e shoqërisë Kosovare dhe u dënua nga të gjithë akterët shtetërorë.

92. 5 vite më vonë, më 10 tetor 2017, u mbajt për herë të parë në Kosovë Parada e Krenarisë në mbrojtje të lirisë së komunitetit LGBTI. Një ditë para paradës, në një email drejtuar mediave kosovare, ishte shkruar ky kërcënim:

“U bëjmë thirrje të gjithë atyre që ia duan të mirën këtij vendi, se me datën 10 Tetor 2017, për shkak të paradës së të degjeneruarve të shoqërisë, iu paralajmërojmë të gjithë qytetarëve të qëndrojnë larg këtij marshi, ose përndryshe do t’u përcjellë i njëjti fat sikur atyre se çfarë do të vie atë ditë! Përgatitjet janë bërë dhe njëherë e përgjithmonë do të shuhen këto ndyrësira të shoqërisë.”⁶⁹

93. Pavarësisht kësaj, Parada kaloi pa asnjë incident dhe një numër i madh njerëzish dolën në mbështetje të komunitetit LGBTI edhe përkundër kërcënimeve për jetë.

94. Këto ndryshime pozitive janë vënë në pah edhe nga Avokati i Popullit në Raportin Vjetor të vitit 2017 ku në mes tjerash theksohet se çështja e komunitetit LGBTI gjithnjë e më shumë po diskutohet në shoqërinë kosovare.⁷⁰ Prandaj pranimi i shqyrtimit të kushtetutshmërisë së Vendimit të ARC nga Gjykata Kushtetuese është i nevojshëm dhe i rëndësishëm për t’i reflektuar ndryshimet pozitive shoqërore në kontekstin ligjor të trajtimit të komunitetit LGBTI nga institucionet vendore në Kosovë.

95. Mirëpo sa i përket kontekstit ligjor, nuk mund të themi se komuniteti LGBTI gëzon mbrojtje të vërtetë ligjore në Kosovë. Avokati i Popullit ka trajtuar sjelljen e autoriteteve relevante në Kosovë në lidhje me adresimin e shkejeve të të drejtave të njeriut të paraqitura nga personat e komunitetit LGBTI në Kosovë.⁷¹ Një ndër konstatimet e Avokatit të Popullit është se institucionet kur pranojnë denoncime për vepra penale të kryera ndaj komunitetit LGBTI, nuk i cilësojnë si vepra penale të orientuara ndaj komunitetit LGBTI.⁷² Pra nuk e cilësojnë veprën penale si të vepër e motivuar dhe e kryer mbi bazën e urrejtjes ndaj orientimit seksual tjetër dhe identitetit gjinor tjetër, por e cilësojnë si vepër penale standarde, pa e përfshirë motivin e vërtetë për kryerjen e saj.

Avokati i Popullit më tej ka ngritur shqetësim për faktin se ende nuk ka asnjë gjykatë që ka shpallur aktgjykim që e shpallë fajtor personin që ka ushtruar dhunë ndaj një personi apo një grupi personash për shkak të orientimit seksual apo edhe identitetit gjinor.⁷⁴

⁶⁸ Balkan Insight, *Attack on Kosovo 2.0 widely condemned*, 17 dhjetor 2012, <http://www.balkaninsight.com/en/article/attack-on-kosovo-2-0-widely-condemned>

⁶⁹ Koha.net, *Kërcënim me vrasje për pjesëmarrësit në „Paradën e Krenarisë“*, 9 tetor 2018, <https://www.koha.net/arberi/49676/kercenim-me-vrasje-per-pjesemarrsit-ne-paraden-e-krenarise/>.

⁷⁰ Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, Raporti Vjetor 2017, faqe 124.

⁷¹ Ibid, në faqe 8; Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, Raporti Vjetor 2017, faqe 124-125.

⁷² Ibid.

⁷³ Ibid, në faqe 8-9.

⁷⁴ Ibid, faqe 9.

96. Poashtu, në kontestet nga marrëdhënia e punës, Avokati i Popullit ka konstatuar se Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi do të duhej të zbatohet nga gjykatat kur palët pretendojnë të ketë pasur shkelje për shkak të orientimit të tyre seksual.⁷⁵ Pra edhe pse ekziston mbrojtja ligjore për komunitetin LGBTI në Kosovë, autoritetet shtetërore hezitojnë ta përdorin legjislacionin përkatës dhe nuk e tematizojnë fare problematikën shoqërore në lidhje me komunitetin LGBTI.

97. Është e qartë se autoritetet shtetërore nuk i shfrytëzojnë ligjet në fuqi për t'i adresuar në mënyrë të mirëfilltë shkeljet dhe rastet që kanë të bëjnë me komunitetin LGBTI. Edhe në rastin e Parashtruesit në asnjërin nga vendimet të nxjerra nga Zyra e Gjendjes Civile dhe ARC, nuk adresohet identiteti gjinor, Ligji për Barazi Gjinore, Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi apo praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, pavarësisht faktit se janë pikërisht këto tri burime mbi të cilat Parashtruesi e ka paraqitur kërkesën e tij për ndërrim të emrit dhe të shënuesit të gjinisë.

98. Me pranimin e shqyrtimit të kushtetutshmërisë, Gjykata Kushtetuese do ta vendoste një standard shumë të nevojshëm në Kosovë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të komunitetit LGBTI në Kosovë. Prandaj edhe konteksti ligjor e politik në lidhje me mbrojtjen e komunitetit LGBTI në Kosovë duhet të konsiderohet në favor të kërkesës së Parashtruesit për tu liruar nga detyrimi i shterjes së të gjitha mjeteve juridike.

Rina Kika

Avokate

⁷⁵ Ibid, faqe 10.

V. DOKUMENTACIONI DHE INFORMATAT PËRCJELLËSE

Autorizimi i Avokates Rina Kika

Prova Nr. 1: Rekomandimi i Psikologut dhe Psikoterapeut Mr.Sci.Enver S. Çeska, i datës 27 dhjetor 2017. Numri i licencës: KO 03713-70.

Prova Nr.2: Raporti Mjekësor, Prof. Dr. Çedomir Dimitrovski, Spitali Klinik Acibadem Sistina i datës 06 qershor 2018.

Prova Nr.3: Kërkesa për ndërrimin e emrit dhe të shënuesit të gjinisë në Regjistrin e Gjendjes Civile drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile, 4 prill 2018.

Prova Nr.4: Vendimi Nr.02-201-02-8319 i Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë i datës 26 prill 2018

Prova Nr.5: Ankesa ndaj Vendimit të Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë, dorëzuar më datë 29 maj 2018

Prova Nr. 6: Vendimi Nr.64-04 i datës 13 qershor 2018, Agjencia e Regjistrimit Civil, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave kundër Vendimeve të Zyrave të Gjendjes Civile, i pranuar më datë 26 qershor 2018

Prova Nr.7: Padi për konfliktin administrativ ndaj Vendimit Nr.64-04 të Agjencisë për Regjistrimin Civil, e dorëzuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, më 24 korrik 2018.

VI. PASQYRA E ZGJEDHJES SË KËRKUAR

Kërkojmë nga Gjykata Kushtetuese që pas shqyrtimit të të thënave të mësipërme dhe provave të bashëngjitura të nxjerrë Aktgjykim dhe vendosë:

I. Të shpallë kërkesën për shqyrtimin e kushtetutshmërisë si të pranueshme;

II. Të gjejë se ka pasur shkelje të së drejtës së privatësisë të paraparë me nenin 36 të Kushtetutës;

III. Të gjejë se ka pasur shkelje të dinjitetit të Parashtruesit sipas nenit 23 të Kushtetutës;

IV. Të gjejë se ka pasur shkelje të të drejtës në mbrojtje të barabartë dhe liri nga diskriminimi sipas nenit 24 të Kushtetutës;

V. Të urdhërojë Agjencinë e Regjistrimit Civil të pranojë si të bazuar kërkesën për ndërrimin e emrit nga “**Bler**ta” në “**Bler**t” dhe të shënuesit të gjinisë nga “**F**” në “**M**” në regjistrin qendror të gjendjes civile për Parashtruesin.

VI. Të urdhërojë Agjencinë e Regjistrimit Civil t’ia kompensojë Parashtruesit dëmin jomaterial në vlerë prej 5'000 euro, si dhe shpenzimet procedurale dhe shpenzimet e avokates.